



REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO  
 AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT  
 AGENCIA PROTIV KORRUPCIE  
 ANTI-CORRUPTION AGENCY

Dep. \_\_\_\_\_  
 Nr. Prot. \_\_\_\_\_  
 Br. Prot. \_\_\_\_\_  
 Prot. No. 0/3858/41  
 Data 05.10.2011  
 Datum \_\_\_\_\_  
 Nr. i faq. \_\_\_\_\_  
 Broj stranica \_\_\_\_\_  
 Nr. pages \_\_\_\_\_

**Republika e Kosovës**  
 PRISHTINE



Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT  
 AGENCIA PROTIV KORRUPCIE  
 ANTI - CORRUPTION AGENCY

REPUBLIKA E KOSOVES - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO  
 QEVERIA E KOSOVES - VLADA KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVO  
 MINISTERIA PËR KOMUNITETE DHE KTHIM  
 MINISTRY FOR COMMUNITIES AND RETURN  
 MINISTRARSTVO ZA ZAJEDNICE I POVRATAK

Njësia org./Org. Jedinica/Org. Unit \_\_\_\_\_

Nr./Br./No. 1219 Data/Data/Date 05.10.2011

Nr. Faqeve/Br. Stranica/No. Pages: \_\_\_\_\_

FUSHË KOSOVË / A

DATE/A:	05.10.2011
REFERENC-Ë:	AKK-DP
PËR/ZA/TO:	z. Blerim Dina Shef i Sektorit të Prokurimit MKK
CC:	z. Zana Kotorri Sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë për Komunitet dhe Kthim.
NGA/OD/FROM:	z. Hasan Preteni, Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me tenderin " Pastrimi i deponive në vendet Mergjinçe, Perqevo dhe Berve në KK Shterpçë - Ritender".



I nderuar, z. Dina

Duke u bazuar në nenin 19 pika 1.16 të Ligjit Nr. 04/L-051 Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik lidhur me tenderin "Pastrimi i deponive në vendet Mergjinçe, Perqevo dhe Berve në KK Shterpçë - Ritender", me nr: MKK-211-11-044-521 në Ministrinë për Komunitet dhe Kthim, ofron këtë:

**OPINION**

Që ju si AK t'i ndërmerrni të gjitha veprimet e nevojshme drejt evitimit të shkeljeve të cekura në arsyetim mënyre që të respektohen dispozitat përkatëse të Ligjit nr. 03/L-241 të Prokurimit Publik të Kosovës.

**Arsyetim**

Zyra e prokurimit në Ministrinë për Komunitet dhe Kthim, si autoritet kontraktues, në dosjen e tenderit "punë" të procedurës së hapur me nr. të prokurimit 211- 11- 044- 521 me titull "Pastrimi i deponive në vendet Mergjinçe, Perqevo dhe Berve në KK Shterpçë - Ritender", në Pjesën, Seksioni II, Fleta e të dhënave të tenderit të neni 6.4 i Dosjes së

Faqe 1 nga 1



tenderit te lidhur me përshtatshmërinë e së drejtës te pika 8 Dokumentet e Kërkuara - ka kërkuar, veç tjerash, sigurimin e Planit dinamik edhe te neni 30.1 i Dosjes së Tenderit-Kriteret për dhënien e kontratës. Zyra e prokurimit këto kërkesa i ka shpalosur edhe njëherë duke i zbërthyer në kuadër të pikës : numër 2 te rubrika tenderi ekonomikisht më i favorshëm, ku ka paraparë: " planin dinamik" pesha e këtij nën kriteri është 20 % të poenimit.

Me aktin e këtyllë të përsëritjes (dyfishimit) të kërkesave të njëjta të tenderit, Autoriteti Kontraktues ka shkelur Ligjin nr.03/L-241 të Prokurimit Publik konkretisht këto dispozita:

- Dispozitën e nenit 51 të LPP-së 03/L-241 dhe
- Dispozitën e nenit 52 të LPP-së 03/L-241.

Zyra e prokurimit në Ministrinë për Komunitet dhe Kthim nuk ka respektuar edhe pjesën 5 të Udhëzimit administrative 04/2011/KRPP të datës 19.05.2011 i cili udhëzimi parasheh që - asnjë kriter në lidhje me kualifikimin e operatorëve ekonomik nuk mundë të përdoren si kriteret për dhënien e kontratës.

*Me respekt*